STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për njoftim të menjëhershëm: 4 nëntor 2012

GUVERNATORI CUOMO NJOFTON PËR 22.8 MILION DOLLARË NË NDIHMË NJU JORKUT PËR TË RIPARUAR IMPIANTET E PASTRIMIT TË UJËRAVE TË ZEZA DHE PËRPJEKJET E TJERA PËR RIMËKËMBJEN

Guvernatori Andrew M. Cuomo njoftoi sot se shteti do t'i japë qytetit të Nju Jorkut 22.8 milion dollarë që do të përdoren për të riparuar impiantet e pastrimit të ujërave të zeza të dëmtuara gjatë uraganit Sandy dhe përpjekjet e tjera të rimëkëmbjes nga stuhia.

“Shteti vazhdon të kërkojë mënyra për të ndihmuar banorët nga pasojat e kësaj stuhie shkatërrimtare”, tha guvernatori Cuomo. “Me nxjerrjen e këtyre fondeve, qyteti i Nju Jorkut do të ketë më shumë mundësi për të vazhduar riparimin e impianteve të pastrimit të ujërave të zeza dhe përballimit të kërcënimit ndaj shëndetit publik dhe mjedisit të shkaktuar nga uragani Sandy”.

22.8 milion dollarë u dhanë nga shteti nga një llogari garancie, financuar nga qyteti i Nju Jorkut sipas kushteve të marrëveshjeve të përcaktuara me Departamentin për Ruajtjen e Mjedisit të shtetit të Nju Jorkut (New York State Department of Environmental Conservation) (DEC) për shkeljet në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza të qytetit në të kaluarën.

Komisioneri i DEC Joe Martens tha se “Qyteti i Nju Jorkut plotësoi kushtet e marrëveshjes për impiantin e Newtown Creek dhe ka angazhuar burime të paprecedent për investimet në infrastrukturën e gjelbër. DEC i liron këto fonde menjëherë për të ndihmuar qytetin në rindërtimin e infrastrukturës mjedisore”.

Komisioneri i Departamentit të Mbrojtjes së Mjedisit të shtetit të Nju Jorkut Carter Strickland tha se, “në saje të punës së madhe dhe përkushtimit të stafit tonë, ne kemi bërë riparime madhore të dëmeve të shkaktuara nga Sandy në impiantet e pastrimit të ujërave të zeza dhe tani ne po i trajtojmë ujërat e zeza në 13 nga të 14 impiantet. Nxjerrja e miliona dollarëve nga llogaria e garancisë do të na ndihmojë për të kryer punën tonë dhe për t'i vënë në punë të gjitha sistemet tona sa më shpejt”.

Duke pasur parasysh dëmet në infrastrukturën e ujërave të zeza si rezultat i uraganit Sandy, si dhe ritmin e lartë të performancës së qytetit sipas këtyre marrëveshjeve, shteti po vepron për të nxjerrë menjëherë fondet për qytetin me qëllim që ato të ndihmojnë përshpejtimin e riparimeve të dëmeve të jashtëzakonshme të shkaktuara nga stuhia.

Qyteti ka standarde shumë të larta të përputhshmërisë me kërkesat e përcaktuara në këto marrëveshje, për trajtimin sekondar në impiantin e trajtimit të ujërave të zeza Newtown Creek

mjaft përpara afatit që përcakton ndërtimin një vit më parë parashikimit. Përveç kësaj, qyteti është angazhuar të kryejë rinovime masive të impianteve të veta dhe këtë vit caktoi 2.4 miliard dollarë për një program infrastrukture të gjelbër moderne për të ulur më tej përmbytjen e kanaleve të ujërave të zeza..

###

Lajme të tjera do t'i gjeni në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418